



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2022:253817

Datë: 18.03.2024

Numri i dokumentit: 05462558

**CAP.nr.70/23**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil**, me gjyqtari individual Adnan Konushevc, në çështjen përbarimore të kreditorit Kompania Rajonale e Mbeturinave “Pastrimi”, sh.a, në Prishtinë, Rruga “Bill Klinton”, p.n, ndaj debitorit O.A nga P..., Rruga H.R nr..., me bazë juridike borxh, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i përgjithshëm, PPP.nr.1230/2018 të datës 26.11.2018, me datë 18.03.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pathemeltë ankesa e debitorit O.A nga P..., Rruga H.R nr..., ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i përgjithshëm, PPP.nr.1230/2018 të datës 26.11.2018, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Prishtinë- Departamenti i përgjithshëm, me aktvendimin e ankimuar, PPP.nr.1230/2018 të datës 26.11.2018, ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit O.A nga P... për borxhin sipas ekstraktit të verifikuar në librat afarist, i ushtruar kundër urdhrorit për lejimin e përbarimit numër P.nr.422/16 datës 19.09.2016, të lejuar nga zyra përbarimore e përbaruesit privat Arsim Bajraktari, për territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka parashtruar ankesë debitori, për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës, të aprovoj si të bazuar në tersi ankesën e debitorit dhe ta anuloj aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, PPP.nr.1230/18 të

datës 26.11.2018, ashtu që të pushohet procedura përmbareme dhe kështu të anulohet urdhri për lejimin e përmbaremit nga zyra e përmbareuesit në territorin e Prishtinës.

Gjyqtari individual i Gjykatës së Apelit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, ashtu që në kuptim të nenit 3, paragrafi 2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbareme si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore, gjeti se:

### **-Ankesa është e pathemeltë**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori ka paraqitur propozim për përmbareme ndaj debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm-ekstraktit të verifikuar nga librat e afariste për pagesën e shërbimeve komunale për bartjen e mbeturinave me ID. Nr.8820, lidhur me borxhin në vlerë prej 409.35 euro, për periudhën kohore nga data 01.01.2009 e deri me datë 29.12.2015. Përmbareuesi privat, ka lejuar përmbaremin e kërkuar nga kreditori, me urdhrin përmbaremor P.nr.422/16 të datës 19.09.2016, kundër këtij urdhri debitori ka ushtruar prapësim me datë 26.09.2018, ndërsa kreditori ka ushtruar përgjigje në prapësim me datë 27.09.2018. Gjykata e shkallës së parë pas vlerësimit të shkresave të lëndës, prapësimi dhe përgjigjes në prapësim, vendosi si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka marr aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, i njëjti është i kuptueshëm dhe i çartë, prandaj vendimin e gjykatës, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata e Apelit, duke vlerësuar aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Duke marr parasysh se në rastin konkret kemi të bëjmë me propozim për përmbareme, në bazë të dokumentit të besueshëm që me dispozitën e nenit 29 të Ligjit për Procedurën Përmbareme nr.04/L-139, ku përcaktohet se përmbaremi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet në bazë të dokumentit të besueshëm dhe se dokument i besueshëm sipas LPP-së janë: ekstraktet e verifikuara nga librat afariste, për pagesa të shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave. Dokumenti i besueshëm, është i përshtatshëm për përmbareme po që se në të është treguar kreditori dhe debitori si dhe

objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar, në rastin konkret kemi të bëjmë me dokument të besueshëm siç është ekstrakti i verifikuar nga libri afarist, ID. Nr.8820, në shumën e përgjithshme për pagesë prej 409.35 euro. Ekstrakti është i përshtatshëm për përmbardim ngase është i dorëzuar në origjinal, në të është cekur kreditori dhe debitori, objekti, lloji dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar, andaj, nga kjo rezulton se dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbardim dhe se gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Pretendimi ankimor i debitorit se me aktvendimi e atakuar nuk është vërtetuar në mënyrë të plotë ose të saktë gjendja faktike, çka ka rezultuar me aplikim jo të drejtë të aplikimit të se drejtës materiale, Gjykata ankimore nuk mund ta pranojë në pretendim të tillë si të bazuar, ngase arsyetimi i aktvendimit të shkallës së parë paraqet një përmbajtje konkrete me rrjedhë logjike për gjendjen e fakteve të konstatuara nga ana gjykatës së shkallës së parë.

Lidhur me pretendimin ankimor se kreditori ka bërë propozim të gabuar për pambardimi pasi që debitori jeton në adresë tjetër dhe nuk i takon që ti paguaj këto shërbime që nuk janë kryer për të, Gjykata e Apelit vlerëson se një pretendim i tillë është pretendim i pabazuar dhe i paqëndrueshëm, ngase në rastin konkret debitori nuk ka ofruar asnjë dëshmi për ndalim e faturimit, nuk e ka argumentuar se nuk është shfrytëzues i shërbimeve të kreditorit, madje sipas postës elektronike - email-it, të kreditorit i datës 17.05.2018, debitori nuk ka bërë marrëveshje me kreditorin për pagesën e borxhit, por përmes bankës NLB, debitori e ka bërë pagesën e taksës në shumën prej 38.94 euro, plus borxhin, në shumën prej 306.61 euro, të paguar me datë 22.11.2016, ndërsa me datë 01.08.2017 debitori e ka paguar edhe shumën borxhit prej 56.40 euro, që sipas këtij email-i, borxhi i debitorit ka mbetur, në shumën prej 678.15 euro. Për më tepër nga kjo rezulton se debitori në vazhdimësi ka qenë në dijeni lidhur me borxhin në raport me shërbimet e ofruara nga kreditori, madje me rastin e mbylljes së llogarisë bankare së debitorit, sipas shënimit zyrtarë të përmbarduesit privat të datës 05.06.2018, debitori ka shkuar në zyrën e përmbarduesit privat, i cili e ka lejuar përmbardimin dhe ka hyr në marrëveshje për pagesën e borxhit, të shumën prej 409.35 euro dhe shpenzimet të procedurës, në shumën prej 129.60 euro, dhe atë për çdo muaj me këste nga 30.00 euro, në muaj. Prandaj kjo gjykatë vlerëson se pretendimet e debitorit janë në tërësi të pabazuar dhe në mungesë të ndonjë prove shkresore që është njoftuar ndonjëherë kreditori nga debitori për ndërrim të adresës apo për mos shfrytëzimin e shërbimeve të ofruara nga kreditori, e ndërsa në anën tjetër kreditori ka vazhduar me kryerjen e shërbimit për të cilat është i thirrur dhe për këtë edhe ka ofruar fatura për çdo muaj duke mos pasur dijeni se kush i shfrytëzon

shërbimet e tij, për këto arsye pretendimet e debitorit siç edhe u vlerësuan më lart rezultojnë të jenë të pabazuar.

Duke marr parasysh pretendimet ankimore të cilat konsistojnë aktvendimit të atakuar, gjykata e shkallës së dytë konsideron se këto pretendimet ankimore janë të pabazuara, ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, të cilat shkelje kjo gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së dhe as shkelje të drejtës materiale të cilave ju referohet debitori në ankese. Andaj, nga të cekurat kjo gjykatë vlerësoj se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë duhet vërtetuar dhe të refuzohet ankesa e debitorit si e pathemeltë.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 209, pika b), të LPK-së.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – PRISHTINË**  
**Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil**  
**CAP.nr.70/2023 më datë 18.03.2024**

**Gjyqtari**  
Adnan Konushevci